



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 427 Prot.

Tiranë, më datë 29.03.2021

VENDIM
Nr. 167, datë 29.03.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 29.03.2021:

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të projektit të miratuar me *Vendim Nr. 486, datë 16.12.2020 "Plani i konservimit, ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në 4 objekte pasuri kulturore" Kisha e Manastirit të Rubikut, Mirditë*", me aplikues dhe zhvillues UNOPS;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 72, pika 1 dhe 2;
3. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
5. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

